

KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 09.05. 2023, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

PALA E PARË: Z. Vullnet Sinaj, i biri i Ruzhdiut, i datëlindjes 24.08.1965, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letër Njoftimit Id Card nr. 033531643 dhe nr. personal G50820205C, përfaqësuar nga **Personi i besuar Znj. Elona Koshi**, e Tekiut, e datëlindjes 04.09.1986, lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 033400499 dhe nr. personal I65904092M, që këtu e në vijim. "**Shitësi**"

PALA E DYTË: Znj. Monika Çela, e bija e Metes, e datëlindjes 14.07.1965 e lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 032287801 dhe nr personal G55714058E, që këtu e në vijim "**Blerësi**"

HYRJE

A. Shoqëria "BIG WILSON" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 15.02.2010, pajisur me nipt L01415023A, me seli në adresën *Sheshi Willson, Pallati Sigal, Kati 1, Tiranë*, me ortakë:

2.1.1 Z. Vullnet Sinaj:

Numri i Pjesëve 1 (një);

Pjesëmarrja në përqindje 100%;

B. Palët kanë rënë dakort që një pjesë të kuotave të zotëruara nga Shitësi, të kalojnë tek Blerësi mbas firmosjes së kësaj kontrate dhe kalimit të pagesës.

C. Shoqëria "BIG WILSON" shpk, dhe ortakë, Z. Vullnet Sinaj, përfaqësuar nga Person i Besuar Znj. Elona Koshi, me vendimin Nr. 5 të datës 09.05.2023, në mënyrë të shprehur kanë dhënë aprovimin e tyre për tjetërsimin e kuotave

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;

1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

Neni 2
Objekti

- 2.1 Shitësi do t'i shesë Blerësit, një pjesë të kuotave të saj, në masën në masën e 49% të kapitalit, nga totali prej 100% (njëqind për qind) që Shitësi zotëron në shoqërinë Big Wilson.
- 2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "BIG WILSON" shpk, do të zotërohet nga ortakët në si më poshtë:

1. Z. Vullnet Sinaj: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Znj. Monika Çela: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 49% (dyzetë e nëntë për qind);

Neni 3
Afati

- 3.1 Afati i kalimit të këtyre kuotave do të jetë një 1 (një) mujore nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

Neni 4
Vlera e shitjes

- 4.1 Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2 Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

Neni 6
Të tjera

- 6.1 Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2 Kontrata redaktohet në 2 kopje, me fuqi të njëjtë.
- 6.3 Bashkangjitur dokumentat:
1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "BIG WILSON" shpk;
 2. Vendim Nr. 05, datë 09.05.2023 i Shoqërisë "BIG WILSON" shpk;
 3. Dokumentat ID të palëve

PALËT:

SHITËSI
Z. Vullnet Sinaj
Person i Besuar
Elona Koshi





BLERËSI
Znj. Monika Çela

